



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 56

Tiranë – E premte, 21 mars 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 13.3.2025	Për lirim nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit..... 6403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 20.3.2025	Për emërim në detyrë..... 6403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 20.3.2025	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tek Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të pronës me emërtimin “Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 6/277, Tiranë, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar..... 6403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 174, datë 20.3.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar..... 6413
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 20.3.2025	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k..... 6413
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 176, datë 20.3.2025	Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të kompensimit për kufizimet që i krijohen punonjësit të policisë për largësinë nga vendbanimi, sipas kostos së transportit publik, të pagës për papunësinë e bashkëshortit, të shkaktuar nga largësia e vendbanimit, dhe të kriterëve e të masës së përfitimit të pagesës së qirasë për strehim..... 6418

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 20.3.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”, të ndryshuar.....	6420
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 20.3.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar.....	6422
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 181, datë 20.3.2025	Për një shtesë në vendimin nr. 19, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”.....	6425
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë për Median dhe Informimin nr. 36, datë 17.3.2025	Për delegimin e kompetencave.....	6425
Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 62, datë 19.3.2025	Për delegim kompetencash.....	6426

**VENDIM****Nr. 169, datë 13.3.2025****PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË
AUTORITETIT KOMBËTAR
TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 65, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Olsi Komici, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 172, datë 20.3.2025****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Andi Memeti emërohet zëvendësministër i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****VENDIM****Nr. 173, datë 20.3.2025****PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME E TATIMEVE TEK
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR, PËR
GJYKATËN E APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, TË
PRONËS ME EMËRTIMIN “DEGA E
TATIMPAGUESVE TË MËDHENJ”,
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE
8150, ME NUMËR PASURIE 6/277,
TIRANË, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 818, DATË 6.12.2006,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve te Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të pronës me emërtimin “Dega e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, ndodhur në zonën kadastrale 8150, me numër pasurie 6/277, Tiranë, për t’u përdorur për ushtrimin e aktivitetit administrativ, sipas kartelës së pasurisë, fragmentit të hartës kadastrale dhe planimetrive prej 6 (gjashtë) fletësh, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 818, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, të ndryshuar.



3. Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm u ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të tretëve.

4. Dorëzimi i pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi bëhet brenda një afati të përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8150029080
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8150, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 6/277, Sipërfaqja Totale 294.5 m²,
(Nga të Cilat Truall 294.5 m²; Ndërtesë 240.5 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-P-12, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia Tirane, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. _____, Dt. 12/09/2011), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Nr. Identifikimi/NIPT K51717017C, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE, Rruga Teodor Keko, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. _____, Datë: 12/09/2011

Regjistruar: Nr. 12493, Datë: 12/09/2011

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afa ti i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afa ti i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIP T

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Erjon GalanxhiVulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date: 2025.02.24 11:49:28 +02'00'
K51717017C2025022411492160ASHKEni
SejdinajDigitally signed by:
Eni Sejdinaj
Date: 2025.02.24
11:54:31 +02'00'Helis
PetaniDigitally signed by:
Helis Petani
Date: 2025.02.24
11:58:24 +02'00'Eni
GalanxhiDigitally signed by:
Eni Galanxhi
Date: 2025.02.24
12:51:15 +02'00'Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

2/2



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENSIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTES KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 8150

KODI UNIK: 8150029080

NUMRI I PASURISE: 6/277

INDEKSI I HARTES: TR-P-13

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPETARE:



SHK: 500

DREJTORI
ERJON GALANXHI

Eni Sejdinaj Helis Petani

Date: 2025.02.24 Date: 2025.02.24


11:56:14 +02'00' 11:57:32 +02'00'

Erjon Galanxhi



Vulosur elektronisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Veri
Date:2025/02/24 09:48:06 +02'00'
K51717017C2025022409475971014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Tiranë Veri)





VENDIM

Nr. 174, datë 20.3.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE
EMËRIMIN E ANËTARËVE,
PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT
QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES
TË FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2, të vendimit nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, zëvendësohet me znj. Anila Denaj, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

2. Znj. Almira Xhembulla, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, zëvendësohet me znj. Ana Kapaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 175, datë 20.3.2025

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
FOTOVOLTAIKE PËR VETËPRODHIM
DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK
ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË
ZONËN E AEROPORTIT TË KUKËSIT,
NJËSIA ADMINISTRATIVE SHTIQËN,
BASHKIA KUKËS, QARKU KUKËS, NGA
SHOQËRIA “GLOBAL TECHNICAL
MECHANICS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në territorin e Aeroportit të Kukësit, sipas vendimit nr. 146, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. dhe ‘Bami’ sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare ‘Kukës International Airport’ sh.p.k., për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit”, me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k.;

b) NIPT/NUIS: L71529026M;

c) Tipi i centralit: fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 12mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në territorin e Aeroportit të Kukësit,



Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës;

e) Afati i operimit: deri në mbarimin e afatit të kontratës së koncesionit, sipas vendimit nr. 146, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave;

ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqëria “*Global Technical Mechanics*” sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaiq;

ii. të respektojë kushtet e përmendura në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara

nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “*Global Technical Mechanics*” sh.p.k. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penaltitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë detyrimin, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “*Global Technical Mechanics*” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku




ANEKS 1

Nr.	Pika	UTM Zone 34N		Albanian 1986 / Gauss-Kruger Zone 4		KRGJSH	
		E:	N:	E:	N:	E:	N:
1	Pika 1	451703.05	4653998.93	4451814.88	4655993.11	534487.18	4655780.46
2	Pika 2	451695.69	4654027.70	4451807.51	4656021.90	534479.48	4655809.16
3	Pika 3	451845.35	4654653.70	4451957.23	4656648.15	534621.87	4656437.11
4	Pika 4	451900.05	4654687.21	4452011.95	4656681.68	534676.19	4656471.27
5	Pika 5	451925.08	4654793.56	4452037.00	4656788.07	534699.99	4656577.95
6	Pika 6	451836.62	4654816.43	4451948.50	4656810.95	534611.23	4656599.79
7	Pika 7	451356.76	4652012.01	4451468.46	4654805.71	534154.67	4654589.12
8	Pika 8	451429.34	4652793.66	4451541.05	4654787.36	534227.47	4654571.62
9	Pika 9	451441.70	4652833.41	4451553.42	4654827.12	534239.37	4654611.52
10	Pika 10	451424.62	4652868.60	4451536.33	4654862.32	534221.87	4654646.52
11	Pika 11	451444.07	4652939.89	4451555.78	4654933.64	534240.49	4654718.06
12	Pika 12	451480.47	4652931.74	4451592.20	4654925.49	534277.00	4654710.34
13	Pika 13	451509.29	4653038.87	4451621.03	4655032.66	534304.58	4654817.83
14	Pika 14	451473.98	4653095.26	4451585.71	4655089.08	534268.60	4654873.83
15	Pika 15	451602.80	4653629.87	4451714.58	4655623.90	534391.21	4655410.11
16	Pika 16	451673	4653626	4451784.81	4655620.03	534461.48	4655407.06
17	Pika 17	451709	4653597	4451820.83	4655591.02	534497.83	4655378.48
18	Pika 18	451557	4652966	4451668.763	4654959.76	534353.16	4654745.50
19	Pika 19	451544	4652882	4451655.76	4654875.73	534341.13	4654661.32
20	Pika 20	451499	4652691	4451610.74	4654684.65	534298.35	4654469.73
21	Pika 21	451465	4652678	4451576.73	4654671.65	534264.49	4654456.33
22	Pika 22	451436	4652570	4451547.71	4654563.60	534236.75	4654347.96
23	Pika 23	451440	4652508	4451551.72	4654501.58	534241.47	4654285.98
24	Pika 24	451283	4652472	4451394.65	4654465.56	534084.84	4654248.14
25	Pika 25	451263	4652551	4451374.64	4654544.60	534063.91	4654326.93
26	Pika 26	451202	4652626	4451313.62	4654619.62	534002.02	4654401.24
27	Pika 27	451223	4652739	4451334.63	4654732.67	534021.70	4654514.52
28	Pika 28	451152	4653038	4451263.60	4655031.79	533947.19	4654812.79
29	Pika 29	451224	4653155	4451335.63	4655148.84	534017.84	4654930.67
30	Pika 30	451368	4653190	4451479.69	4655183.85	534161.48	4654967.36
31	Pika 31	451611.48	4654104.64	4451723.26	4656098.87	534394.34	4655885.14
32	Pika 32	451603.19	4654149.87	4451714.97	4656144.12	534385.52	4655930.29
33	Pika 33	451697.72	4654475.08	4451809.55	4656469.45	534476.28	4656256.70
34	Pika 34	451740.00	4654499.35	4451851.83	4656493.74	534518.28	4656281.48
35	Pika 35	451810.62	4654936.84	4451922.49	4656931.41	534583.82	4656719.93
36	Pika 36	451823.40	4654934.38	4451935.27	4656928.95	534596.63	4656717.62
37	Pika 37	451703.05	4653998.93	4451814.88	4655993.11	534487.18	4655780.46
38	Pika 38	451695.69	4654027.70	4451807.51	4656021.90	534479.48	4655809.16
39	Pika 39	451845.35	4654653.70	4451957.23	4656648.15	534621.87	4656437.11



ZONA	PIKA	Koordinatat në KRGJSH		Albanian 1986/ Gauss-Kruger Zone 4	
		E:	N:	E:	N:
ZONA A	Pika 1	534457.404	4655412.086	4451780.79	4655625.1
	Pika 2	534510.23	4655405.91	445 1833.54	4655618.30
	Pika 3	534506.056	4655392.00	445 1829.2 1	4655604.44
	Pika 4	534483.1 19	4655375.641	445 1806.083	4655588.35
	Pika 5	534338.on	4654761.939	445 1653.87	4654976.379
	Pika 6	534333.72	4654740.538	445 1649.269	4654955.0302
	Pika 7	534317.628	4654723.954	445 1632.98	4654938.63
	Pika 8	534302.671	4654726.127	445 161 8.053	4654940.98
ZONA C	Pika 9	534299.20	4654713.7	445 1614.437	4654928.59
	Pika 10	534310.297	4654711.14	445J625.50	4654925.9072
	Pika 11	534335.262	4654665.841	4451649.93	4654880.3186
	Pika 12	534290.36	4654473.798	4451602 .7950	4654688.8090
	Pika 13	534254.931	4654478.487	445 1567.422	4654693.91
ZONA F	Pika 14	534070.978	4654481.795	4451383.516	4654699.369
	Pika 15	534 101.71	4654612.932	4451415.779	4654830.1410
	Pika 16	5340 10.49	465462 1.966	4451324.66	4654840.240
	Pika 17	534057.744	4654490.599	4451370.385	4654708.327
ZONA G	Pika 18	534 102.92	4654617.732	451305.385	4652841.21
	Pika 19	534 151.355	4654823.333	4451467.88	4655039.952
	Pika 22b	534015.775	4654853.253	4451332.65	4655071.455
	Pika 23	533985.J 13	4654685.557	4451300.03	4654904.12
	Pika 24	534005.874	4654627.603	4451320.119	4654845.93
ZONA H	Pika 19	534 151.355	4654823.333	4451467.88	4655039.95
	Pika 20	534 179.621	4654949.218	4451497.61	4655165.50I
	Pika 21	534151.428	4654953.47	4451469.474	4655170.08
	Pika 22	534028.022	4654904.478	445 1345.501	4655122.534
	Pika 22b	534015.775	4654853.253	445 1332.656	4655071.45
ZONA D & E	Pika 25	534023.501	4654542.365	8554334.59	4603500.46
	Pika 26	533967.826	4654688.462	445 1282.78	4654907.23
	Pika 27	5340I 7.CI96	4654911.33	4451334.655	4655129.514
	Pika 28	534168.747	4654%7.(142	445 1486.951	4655183.451
	Pika 29	534170.981	4654988.049	4451489.430	4655204.431
	Pika 30	534162.629	4654989.679	4451481.09	4655206.15
	Pika 31	534151.3	4654973.426	4451469.579	4655190.039
	Pika 32	534044.259	4654941.678	445 1362.17	4655159.543
	Pika 33	5340 14.693	4654942.744	4451332.62	4655160.9549
	Pika 34	533937.80	4654798.035	4451254.039	4655017.1509
	Pika 35	533973.722	4654635.318	4451288.058	4654854.021
	Pika 36	534009.40	465454 1.129	4451322.6344	4654759.41
ZONA I	Pika 37	534 185.152	4655014.8	445 1503.91	4655231.015
	Pika 38	534173.821	4655017.799	445 1492.6179	4655234.147
	Pika 39	534337.321	4655692.745	445 1663.998	4655907.151
	Pika 40	534326.933	4655694.685	445 1653.633	4655909.2 12
ZONA B	Pika 41	534493.43	4655329.493	4451815.85	4655542.091
	Pika 42	534521.151	4655322.967	4451843.498	4655535.242
	Pika 43	534525.872	4655292.931	4451847.867	4655505.152
	Pika 44	534482.9	4655273.136	4451804.66	4655465.66
	Pika 45	534475.04	4655275.005	4451796.828	4655487.821





VENDIM

Nr. 176, datë 20.3.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E
TË PROCEDURAVE TË KOMPENSIMIT
PËR KUFIZIMET QË I KRIJOHEN
PUNONJËSIT TË POLICISË PËR
LARGËSINË NGA VENDBANIMI, SIPAS
KOSTOS SË TRANSPORTIT PUBLIK, TË
PAGËS PËR PAPUNËSINË E
BASHKËSHORTIT, TË SHKAKTUAR
NGA LARGËSIA E VENDBANIMIT, DHE
TË KRITEREVE E TË MASËS SË
PËRFITIMIT TË PAGESËS SË QIRASË
PËR STREHIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2, shkronja “b”, e 4, të nenit 104, dhe të pikës 2, të nenit 107, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PAGESA PËR KOMPENSIM UDHËTIMI

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, kur emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme jashtë vendbanimit të tij, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

- Nga 36 km deri 60 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj;
- Nga 61 km deri 100 km, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;
- Nga 101 km deri 150 km, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj;
- Nga 150 km deri 200 km, në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj;
- Mbi 200 km, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në muaj.

2. Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë, që nënkupton sistemimin me banesë brenda juridiksionit të strukturës së Policisë së Shtetit, në territorin ku ai është i emëruar/transferuar.

Kompensimin e udhëtimit e përfiton edhe punonjësi i Policisë së Shtetit që plotëson kushtet e pikës 1, të këtij kreu, brenda qarkut ku është i emëruar/transferuar.

3. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1, të këtij kreu, punonjësi i policisë paraqet në organin ku

emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Kërkesën me shkrim pranë njësisë shpenzuese ku është i punësuar punonjësi i Policisë;
- Fotokopjen e kartës së identitetit;
- Vërtetimin nga organi publik përgjegjës nëse punonjësi i policisë ka banesë në pronësi ose në proces legalizimi në juridiksionin e strukturës së Policisë së Shtetit, ku emërohet apo transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme.

II. PAGESA PËR PAPUNËSINË E BASHKËSHORTES/IT

1. Kur punonjësi i policisë emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme për nevoja pune dhe shërbimi dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i humbet marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

- 50 % të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 (një) vit dhe shtesë në masën 5% të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, për çdo vit mbi 1 (një) vit, por jo më shumë se paga bazë minimale në shkallë vendi;
- 100 % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150% të pagës bazë minimale mujore në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 (dhjetë) vjet.

2. Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it rritet sipas indeksit të pagës minimale, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

3. Vjetërsia në punë e bashkëshortes/it konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi/e apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhave të trajtimit me pagesë papunësie.

4. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortit/es së punonjësit të policisë llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës, për efekt pensioni. Kontributet e sigurimeve shoqërore derdhen në emër të bashkëshortit/es përfitues/e nga struktura e Policisë së Shtetit ku është emëruar/transferuar punonjësi i policisë dhe përfituesi sipas skemës së



sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë. Paga mbi të cilën derdhen kontributet të jetë paga bazë minimale mujore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1, të këtij kreu, punonjësi i policisë paraqet në organin, ku emërohet ose transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesën me shkrim me gjenealitetet e plota, ku përshkruhet:

- i. organi ku ka punuar;
- ii. data e transferimit ose emërimit;
- iii. arsyeja e transferimit;
- iv. adresa ku ka banuar;

v. adresa aktuale ku banon pas transferimit ose emërimit;

vi. qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkaku i largimit nga puna.

b) Vërtetimin e pagës mesatare mujore të vitit të fundit kalendarik të punës për pagesën e marrë nga bashkëshortja/bashkëshorti.

c) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore për kontributet e derdhura nga bashkëshorti/bashkëshortja për periudhën e punësimit.

ç) Librezën e punës së bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të transferimit të bashkëshortes/it.

d) Vërtetimin nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkues i papunë dhe nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo tre muaj në zyrën e personelit.

6. Në çdo 6 (gjashtë) muaj, njësitë shpenzuese të strukturave të Policisë së Shtetit dërgojnë në zyrat rajonale të punësimit listën emërore të bashkëshortëve, për trajtimin me përparësi nga këto zyra të punësimit të tyre, në rastet e hapjes së vendeve të lira.

III. QIRAJA PËR STREHIM

1. Kur punonjësi i policisë emërohet/transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda vendit dhe jashtë vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo.

2. Punonjësi i policisë që emërohet/transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda vendit, përfiton kompensim për qira banese, nëse emërohet/transferohet për shkak të detyrës dhe/ose për nevoja pune, në largësi mbi 36 km.

3. Masa e kompensimit për qira banese për punonjësin e policisë të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, është, si më poshtë vijon:

a) kur punonjësi i policisë nuk merr me vete në vendin e ri të punës në të cilin emërohet/transferohet pjesëtarët e familjes, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 43.93 m²;

b) kur punonjësi i policisë ka në ngarkim dhe një person dhe e merr në vendin e ri të punës në të cilin emërohet/transferohet, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 56.47 m²;

c) kur punonjësi i policisë ka në ngarkim dhe dy persona dhe i merr në vendin e ri të punës në të cilin emërohet/transferohet, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 79.74 m²;

ç) kur punonjësi i policisë ka në ngarkim dhe tre persona a më shumë dhe i merr në vendin e ri të punës në të cilin emërohet/transferohet, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 80.50 m².

4. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Policisë vërtetohet me certifikatën e gjendjes familjare.

5. Njësia shpenzuese në strukturën e Policisë së Shtetit bën kompensimin e qirasë së banesës të punonjësit të policisë, përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në vendimin nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”. Vlera minimale mujore e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira do të përllogaritet në bazë të vlerës mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë, sipas njësive administrative, të përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”, që miratohet çdo vit.

6. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 2, të këtij kreu, punonjësi i policisë paraqet në organin ku është emëruar ose transferuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kërkesën me shkrim pranë njësisë shpenzuese ku është i punësuar;

b) Fotokopjen e kartës së identitetit;

c) Kontratën e noterizuar të qirasë së banesës në juridiksionin territorial të strukturës së Policisë së Shtetit ku është i transferuar ose emëruar;



ç) Vërtetimin nga organi publik përgjegjës nëse punonjësi i policisë ka banesë në pronësi ose në proces legalizimi në juridiksionin e strukturës së Policisë së Shtetit, ku emërohet apo transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme.

7. Punonjësi i policisë, që përfiton trajtim me qira banese, nuk do të trajtohet me pagesë për kompensim udhëtimi, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

8. Përfitimi vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë, që nënkupton sistemimin me banesë në juridiksionin territorial të strukturës së Policisë së Shtetit ku ai bën pjesë.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Njësia shpenzuese në strukturën e Policisë së Shtetit, ku punonjësi i policisë është emëruar apo transferuar në mënyrë të përhershme apo të përkohshme, ngre komisionin për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur sipas pikës 3, të kreut I, pikës 5, të kreut II, dhe pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi.

2. Punonjësi, që përfiton, sipas krerëve I dhe II, paraqet çdo vit, që nga dita e përfitimit të kësaj të drejte, dokumentacionin justifikues pranë komisionit të ngritur nga titullari i njësies shpenzuese ku është emëruar ose transferuar.

3. Përfitimi i pagesës, sipas pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, mund të përfitohet për një periudhë deri në 7 (shtatë) vjet. Bashkëshortja/i, që ka përfituar sipas pikës 5, të vendimit nr.256, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, të ndryshuar, vazhdon të përfitojë pagesën, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të kreut II të këtij vendimi, por jo më shumë se 7 (shtatë) vjet gjithsej. Bashkëshortja/i, që ka përfituar sipas pikës 3, të vendimit nr. 183, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, dhe pikës 9, të vendimit nr. 256, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, të ndryshuar, vazhdon të përfitojë pagesën, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”

dhe “b”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet gjithsej.

4. Vendimi nr. 256, datë 25.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, të ndryshuar, si dhe pikat 1 deri në 9, të vendimit nr. 398, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësin e Policisë së Shtetit”, shfuqizohen.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Policisë së Shtetit.

6. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 177, datë 20.3.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 421, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE, DOKUMENTACIONIN, AFATET E SHQYRTIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA TË LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË LEJUARA ME ARMËT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 18/2, pika 3 e 19, pika 3, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e shqyrtimit të kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:



1. Kudo në tekst, fjalët “... si dhe trajnimet specifike, sipas pozicionit të punës së punonjësit,” dhe “... si dhe trajnimet specifike të punonjësit ...” zëvendësohen me “... diplomë/certifikatë, që vërteton përfundimin e studimeve ushtarake apo kursin e avancuar të nënoficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në institucione të huaja të njësura ose dëshmi dhe certifikata të përfuara për veprimtarinë me armët, të njësura apo të lëshuara nga Akademia e Sigurisë.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për t’u pajisur me licencë për veprimtaritë e lejuara me armë nga Policia e Shtetit, personi fizik/tregtari i pajisur me NUIS, personi juridik i pajisur me NUIS ose përfaqësuesi ligjor i subjektit juridik, për secilën nga licencat e përcaktuara nga shkronjat “b” deri në “dh”, të nenit 14, të ligjit nr. 74, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, aplikon në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” dhe dorëzon në formë elektronike dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, për personin fizik, ortakët/aksionarët e personit juridik, drejtuesin teknik, sipas udhëzimit nr. 88, datë 10.3.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shëndetësisë, “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

b) Dëshminë “Për aftësimin teorik dhe praktik për përdorimin e armës”;

c) Kontratën e punës me drejtuesin teknik;

ç) Mandatpagesën.

Dokumentacioni që siguron institucioni, pas autorizimit dhe dhënies së pëlqimit nga aplikanti, është vërtetimi i verifikimit të gjendjes gjyqësore (dëshmia e penalitetit).”.

b) Në pikën 3.1, shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Për personat, që do të punësohen në këto subjekte, të cilët do të kryejnë një procedurë pune në veprimtarinë me armët, personi fizik ose juridik dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, këto dokumente:

i. Kontratë pune me personin e punësuar;

ii. Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit nr. 88, datë 10.3.2015, të

ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shëndetësisë, “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

iii. Dëshmi e aftësimit teorik e praktik për përdorimin e armës, diplomë/certifikatë, që vërteton përfundimin e studimeve policore në Akademinë e Sigurisë, diplomë/certifikatë, që vërteton përfundimin e studimeve ushtarake apo kursin e avancuar të nënoficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në institucione të huaja të njësura, ose dëshmi dhe certifikata të përfuara në fushën e rendit e të sigurisë publike, të njësura apo të lëshuara nga Akademia e Sigurisë.

b) Në rastet e personave juridikë, dokumenti i parashikuar në nënndarjen “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 3.1, të këtij vendimi, për pronarët përfitues.”.

c) Pika 3.2 shfuqizohet.

ç) Pika 3.4 shfuqizohet.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Struktura përgjegjëse në Komisaratin e Policisë e ngarkuar me detyrën e pranimi të dokumenteve, Zyra për Shërbimin e Qytetarëve (ZSHQ), verifikon dokumentacionin e dërguar *on-line* dhe, në rast se konstaton se dokumentacioni i bashkëngjitur në sistem nuk është konform akteve ligjore/nënligjore, e njofton aplikuesin nëpërmjet portalit “*e-Albania*” për plotësimin e dosjes bashkë me dokumentacionin e duhur brenda 5 (pesë) ditëve.”.

ii. Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) ZSHQ-ja verifikon dosjen e plotësuar të aplikantit, përgatit relacionin vlerësues dhe ia përcjell elektronikisht dosjen për ta shqyrtuar Komisionit Qendror të shqyrtimit të kërkesave për licencim/autorizim për veprimtaritë e lejuara me armët në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”.

iii. Shkronja “d” shfuqizohet.

iv. Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Komisioni Qendror mblidhet çdo muaj, shqyrton dokumentacionin për pajisjen me licencë për veprimtarinë e lejuar me armë dhe merr vendim për miratimin ose refuzimin e licencës. Vendimi nënshkruhet elektronikisht/me vulë elektronike.”.



b) Fjalja e parë e pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Refuzimi i dhënies së licencës bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit Qendror dhe akti i refuzimit të licencës me vulë elektronike/nënshkrim elektronik i dërgohet aplikantit në rrugë elektronike në portalin “e-Albania”, nëpërmjet Komisarariatit të Policisë, që ka pranuar aplikimin *on-line*.”.

c) Fjalja e tretë e pikës 6 shfuqizohet.

ç) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Për ripërtëritje të licencës, personi fizik/juridik dorëzon në formë elektronike, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, të njëjtat dokumente si kur aplikon për herë të parë. Kërkesa për ripërtëritjen e licencës bëhet 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj.”.

d) Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 7.1, ndryshojnë, si më poshtë vijon:

“a) në rastin e personave juridikë, për pronarët përfitues dorëzohet certifikata mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit nr. 88, datë 10.3.2015, “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

b) për personat që do të punësohen në këto subjekte, të cilët do të kryejnë një procedurë pune, që lidhet drejtpërdrejt me armët, dorëzohen këto dokumente:

i. Kontratë pune me personin e punësuar;

ii. Certifikatë mjekësore për veprimtaritë e lejuara me armët, sipas udhëzimit nr. 88, datë 10.3.2015, “Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët”, lëshuar nga autoriteti përkatës brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

iii. Dëshmi e aftësisë teorik e praktik për përdorimin e armës dhe diplomë/certifikatë, që vërteton përfundimin e studimeve policore në Akademinë e Sigurisë, diplomë/certifikatë, që vërteton përfundimin e studimeve ushtarake apo kursin e avancuar të nënoficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në institucione të huaja të njësura, ose dëshmi dhe certifikata të përfutur në fushën e rendit e të sigurisë publike, të njësura apo të lëshuara nga Akademia e Sigurisë.

Dokumentacioni që siguron institucioni, pas autorizimit dhe dhënies së pëlqimit nga aplikanti, është vërtetimi i verifikimit të gjendjes gjyqësore (dëshmia e penalitetit).”.

dh) Pika 7.2 shfuqizohet.

4. Shkronja “a” e pikës 10, të kreut IV, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Për ushtrimin e veprimtarisë “Import dhe tregtim të armëve të kategorisë “C” (gjahut) dhe “D” (sportive), pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre”, si dhe të veprimtarisë “Tregtimi i armëve të kategorisë “B”, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre”, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit, sipas kushteve të miratuara me vendimin nr. 275, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë së armëve”, të ndryshuar.”.

II. Kërkesat e procedurat administrative që preken nga ky vendim zbatohen në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen dhe trajtimin e aplikimeve në sistemin e trajtimit të aplikimeve për qytetarët dhe subjektet tatimpaguese.

III. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 180, datë 20.3.2025

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 887, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT E MENAXHIMIT TË INVESTIMEVE PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16 e 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e



menaxhimit të investimeve publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fjalinë e dytë, të pikës 1, pas fjalëve “... arritjen e rezultateve të synuara, ...” shtohen “... brenda një kohe të caktuar, ...”.

2. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e dytë, fjalët “... të rankuar dhe ...” hiqen;

b) Në fund të pikës, fjalët “... apo të pajisjeve të zyrave.” zëvendësohen me “... apo të pajisjeve të zyrave, si dhe projektet në fushën ushtarake.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Projektet e investimeve strategjike, të cilat propozohen për t’u zbatuar si projekte koncesioni apo partneriteti publik privat, maturohen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, pasi përgatitet studimi i fisibilitetit, duke ndjekur rregullat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për koncesionet dhe partneritetet publike private.”.

4. Në fjalinë e dytë, të pikës 5, fjalët “... jo më vonë se data 1 korrik.” zëvendësohen me “... çdo 3 muaj.”.

5. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “..., në përputhje me përcaktimin e nenit 22, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.” hiqen dhe pas fjalëve “... Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).” shtohen “... apo buxhetit vjetor.”.

b) Në fund të shkronjës “c” shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Shpenzimet për projekte investimesh klasifikohen në:

i. projekte strategjike, të cilat janë mbi vlerën kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave. Këto projekte, për t’u përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, i nënshtrohen një procesi të vlerësimit, sipas aneksit 1 të këtij vendimi;

ii. projekte, të cilat janë brenda vlerave kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave. Këto projekte, përpara fillimit të procesit buxhetor, duhet të përgatisin formularin e konceptimit të projektit të investimit dhe studimin e fisibilitetit të thjeshtuar, sipas metodologjisë së miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat;

iii. projekte të tjera investimesh, për të cilat përgatitet formulari i konceptimit të projektit të investimit.”.

6. Në pikën 8 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “..., jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së propozimit nga njësitë e qeverisjes qendrore.” hiqen.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Institucioni përgjegjës për programimin strategjik vlerëson projektet e propozuara nga institucionet e qeverisjes qendrore, në kuadër të përfshirjes së tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Institucioni përgjegjës për programimin strategjik konsulton çdo projektpropozim, si dhe projektet që kanë përgatitur studimin e fisibilitetit dhe plotësojnë kriteret e maturitetit të projektit, sipas metodologjisë së miratuar me udhëzim të ministrit të Financave, në Komitetin e Planifikimit Strategjik, rast pas rasti.”.

c) Paragrafi parë i shkronjës “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Për projektet e investimeve publike, të cilat përfshihen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, përpara maturimit, institucioni propozues paraqet studimin e fisibilitetit, duke siguruar cilësinë e konceptimit dhe të përmbajtjes, në përputhje me metodologjinë e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, për të cilat: ...”;

ç) Në nënndarjen “ii” të shkronjës “c”, fjalët “... jep mendim për ...” zëvendësohen me fjalën “... vlerëson ...”;

d) Nënndarja “iii” e shkronjës “c” shfuqizohet.

dh) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “c/1”, me këtë përmbajtje:

“c/1) Përjashtimisht, për nevoja emergjente ose për nevoja të ofrimit të shërbimeve jetike, kur është e pamundur koha për përgatitjen e studimit të fisibilitetit, projektet e investimeve strategjike maturohen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare nëpërmjet paraqitjes së studimit teknik.”.

e) Në shkronjën “d”, fjalia e fundit zëvendësohet me fjalinë, si më poshtë vijon:

“Propozimet paraqiten si pjesë përbërëse e kërkesave buxhetore, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo buxhetit vjetor.”.

ë) Pas shkronjës “d” shtohen shkronjat “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, me këtë përmbajtje:

“e) Për projektet me rëndësi strategjike të maturuara në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, në rast se në momentin e buxhetimit kanë ndryshime në vlerat e plota të



projektit, institucioni propozues paraqet relacion të detajuar me argumentimin përkatës të ndryshimit të vlerës dhe vlera e rishikuar e projektit reflektohet në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Në rast se ndryshimi i vlerës mbi 20% të vlerës së plotë të projektit vjen si pasojë e ndryshimeve teknike të projektit, duhet të përcillet studim fisibiliteti i rishikuar;

e) Projektet, të cilat janë maturuar në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare dhe nuk janë buxhetuar brenda tri viteve nga kryerja e studimit të fisibilitetit, për t'u buxhetuar, duhet të rishikojnë studimin e fisibilitetit;

f) Ministri i Financave, me udhëzim, miraton metodologjinë e përgatitjes së studimit të plotë të fisibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fisibilitetit;

g) Për projektet me rëndësi strategjike, për të cilat vlera e plotë e projektit rivlerësohet gjatë zbatimit, reflektohet vlera e ndryshuar në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare;

gj) Projektet e investimeve publike të miratuara në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare përfshihen në listë deri në sigurimin e plotë të vlerës së financimit.”.

7. Në aneksin 1, “Procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në paragrafin e përkufizimit “Projekt investimi”, pas fjalëve “... me qëllime qartësisht të identifikuar.” shtohen “... pavarësisht burimit të financimit.”;

b) Në pikën 3, pas fjalëve “... të përgatitjes dhe financimit të PBA-së ...” shtohen “... apo buxhetit vjetor ...”;

c) Në ndarjen “Faza II: Përgatitja dhe dërgimi i kërkesës së projektit të investimit”, “Hapi 4”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Pas fjalisë “Gjithsesi, ky kusht nuk i heq të drejtën projektpropozuesit për të kërkuar financim për të realizuar studimin e fisibilitetit dhe çdo financim tjetër për të maturuar projektin e investimit.” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për projektet në kategorinë “Shpenzime për projekte investimesh”, të cilat kanë vlerë të plotë brenda vlerave kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, përpara fillimit të procesit buxhetor, duhet të përgatitet, krahas formularit (F-3), edhe studimi i fisibilitetit të thjeshtuar, sipas metodologjisë së miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.”.

ii. Fjalja “Për të gjitha pyetjet në formularët përkatës projektpropozimi duhet të marrë vlerësimin “kalim”, përndryshe do të kthehet për zhvillim të mëtejshëm.” shfuqizohet.

ç) Në ndarjen “Faza III: Analiza, miratimi dhe financimi i projektpropozimeve të investimeve publike”, “Hapi 6”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ministria përgjegjëse për financat – pasi propozimet mbërrijnë në ministrinë përgjegjëse për financat, kërkesat për projekte investimesh delegohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike (DMIP) për rishikim dhe vlerësim përfundimtar.”.

ii. Fjalët “... jo më vonë se 14 ditë nga data e marrjes së kërkesës nga njësitë e qeverisjes qendrore.” hiqen.

iii. Pas paragrafit që fillon me fjalët “Formularët shoqërues (F-3) ...” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“- Formularët shoqërues (F-3) për projektet e reja dhe studimet e thjeshtuara të fisibilitetit, për projektpropozimet, të cilat klasifikohen sipas pikës 6, shkronja “c”, nëndarja “ii”, shpenzime për projekte investimesh, të cilat janë brenda kufijve financiarë të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave.”.

iv. Pas paragrafit që fillon me fjalët “Institucionin përgjegjës për programimin strategjik ...” shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Institucionet e qeverisjes qendrore raportojnë pranë institucionit përgjegjës për programimin strategjik për projektet e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare vetëm për efekte të maturitetit të projekteve. Forma, afatet dhe informacioni i raportuar miratohen me urdhër të titullarit të institucionit përgjegjës për programimin strategjik.”.

d) Në ndarjen “Faza III: Analiza, miratimi dhe financimi i projektpropozimeve të investimeve publike”, “Hapi 7” bëhen këto ndryshime:

i. Para fjalëve “Shpenzime për projekte investimesh” të VKM-së, por që nuk përmbushin kriteret për t'u klasifikuar si projekte strategjike, sipas kriterëve të tabelës 1 të këtij aneksi dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës së financave” shtohen “..., nëndarjet “ii” dhe “iii”, ...”.

ii. Para fjalëve “Shpenzime për projekte investimesh” të VKM-së dhe përmbushin kriteret



për t'u klasifikuar si projekte strategjike, sipas kriterëve të tabelës 1 të këtij aneksi dhe vlerës kufi të përcaktuar me udhëzim të ministrit përgjegjës të financave, bazuar në rankimin e projekteve të gatshme për financim, në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, dhe në përputhje me hapësirën fiskale” shtohen “... nëndarja “I”...”.

dh) Në ndarjen “Faza III: Analiza, miratimi dhe financimi i projektpropozimeve të investimeve publike”, “Hapi 9”, pas fjalëve “... Kuvendin e Shqipërisë...” hiqet fjala “... vetëm...” dhe pas fjalëve “... të PBA-së/buxhetit vjetor...” hiqen “... por që nuk miratohet nga Kuvendi.”.

8. Shtojca 4, “Studimi i fisibilitetit”, bashkëlidhur vendimit, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 181, datë 20.3.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 19, DATË 9.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2025, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, përmendur në pikën 1, të vendimit nr. 19, datë 9.1.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”, në ndarjen “Gr. 16, Ministria e Brendshme”, shtohet nëndarja përkatëse, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme të depozitojë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve me kontratë së bashku me kategorinë e pagës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Gr	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve 2025	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
16	Ministria e Brendshme	3			
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	3	Teknik i mesëm	8 orë/ditë	1.3.2025–31.5.2025

URDHËR
Nr. 36, datë 17.3.2025

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të rregullores së brendshme të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 24.2.2022, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave, znj. Denada Qirici, zëvendës drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim, për të gjitha procedurat që lejon ligji, për aq sa është e mundur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë kompetencën për kalimin e pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpenzimeve operative, në Agjencinë për Media dhe Informim.

2. Arsyeja e delegimit të kompetencave lidhet me mungesën e drejtorit të përgjithshëm.



3. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen për periudhën nga data 18.3.2025 deri në datën 7.4.2025.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Qirici, zëvendësdyrëtor i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Alteo Hysi

URDHËR
Nr. 62, datë 19.3.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimet publike”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2008, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe “Rregullores së brendshme të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024 (në vijim “Rregullore e brendshme”)

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, znj. Blerta Nerguti, sekretar i përgjithshëm, për kryerjen e funksioneve të mëposhtme:

a) Nëpunës Autorizues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

b) titullarit të entit kontraktor në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik;

c) titullarit të Autoritetit Publik në zbatim të dispozitave ligjore për të drejtën e informimit;

ç) nënshkrimin e të gjitha akteve me karakter administrativ.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, drejtorëve të përgjithshëm, si vijon:

a) drejtori i përgjithshëm për të Drejtën e Informimit, nënshkruan akte që lidhen me administrimin, shqyrtimin dhe procesin e hetimit administrativ, sipas legjislacionit për të drejtën e informimit;

b) drejtori i përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nënshkruan aktet që lidhen me administrimin, shqyrtimin dhe procesin e hetimit administrativ, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe drejtorët e përgjithshëm pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER
Besnik Dervishi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

